



Prishtinë: 27.12.2019
Kodi i ZRRE-së: V_1221_2019

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Dëshmitë e paraqitura nga palët; dhe
- Rekomandimin e DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_R_2012_12_19**.

në seancën e mbajtur më datë 27.12.2019, nxori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** ankesa e konsumatorit G.T. nga Prishtina si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi
- II. **OBLIGOHET** KESCO dhe KEDS që t'i mundësoj lidhjen/kyçja e re parashtruesit të kërkesës G.T.

A r s y e t i m

Pranë Zyrës së Rregullatorit për Energji parashtruesi i ankesës G.T. ka parashtruar ankesë me të cilën ka kundërshtuar përgjigjën e lëshuar nga KESCO për mos dhënien e lidhjes/kyçjes së re në rrjetin elektrik, si dhe ka kërkuar ti shqyrtohet edhe njëherë ankesa dhe t'i mundësohet lidhje/kyçja e re në rrjetin elektrik.

Bordi i ZRRE-së, me qëllimit të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike e cila është iniciuar nga palët në kontest lidhur me pikën matëse të theksuar më lartë ka shqyrtuar dhe analizuar në detaje të gjitha dëshmitë e mbledhura për veprimet e ndërmarra nga palët në kontest lidhur me këtë pikë matëse.

Me datë 21.06.2016 parashtruesi i ankesës G.T. ka parashtruar kërkesë në KEDS për lidhje të re.

Provë: Kërkesa e parashtruar në KEDS me datë 21.06.2016

Me datë 20.07.2019 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e pikave matëse kanë dalur te konsumatori dhe kanë konstatuar se në objektin ku kërkohet lidhje a re ekziston një shifër aktiv e evidentuar me shifër DPR – 90088446 në emër të NTP “EKO-Pelet” Avni Abazi.

Provë: Procesverbal i inspektimit nr.0708540 i datës 20.07.2019 i datës 22.01.2018

Me datë 25.09.2019 Departamenti për Konsumator në KESCO i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar përkohësisht kërkesën e konsumatorit në arsyetimin e sipas procesverbalit të inspektimit të KEDS nr.0708540 të datës 20.07.2019 në objektin ku është kërkuar kyçje e re ekziston një shifër aktive DPR – 90088446 në emër të NTP “Eko-Pelet” Avni Abazi. KESCO në ankesën e tyre kanë theksuar se shifra DPR – 90088446 është regjistruar me datë 30.04.2014 në emër të NTP “Eko-Pelet” Avni Abazi dhe se bazuar në nenin 8 të kontratës së qeradhënies mes dy palëve theksohet se kontestet eventuale nëse nuk zgjidhen mes palëve, barten në Gjykatën Themelore në Prishtinë. KESCO ka theksuar se pronari i objektit G.T. është dashur të jetë në dijeni se bazuar në kontratën mes



palëve e që ndërlidhen me objektin, si dhe ngarkesat komunale t'i zgjidhin në mes vete, në rast mosmarrëveshjes t'i drejtohen Gjykatës, dhe se objekti në fjalë ka detyrime të pa shlyera e poashtu edhe të shpenzimeve të energjisë elektrike. KESCO në fund ka theksuar se bazuar në të dhënat në dispozicion dhe pas pranimit të dëshmisë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve është e gatshme të bëjë kyçjen e njehsorit elektrik dhe të ndërmerr hapa e nevojshme për ndërrim emri respektivisht marrëdhëniet kontraktuale mes G.T. dhe KESCO.

Provë: Përgjigja e KESCO-s e datës 25.09.2019

Pas kësaj konsumatori ka parashtruar ankesë në ZRRE duke kundërshtuar përgjigjen e lëshuar nga KESCO si dhe ka kërkuar ti shqyrtohet mundësia e kyçjes në rrjetin elektrik. Konsumatori në ankesën e tij ka theksuar se është pronar i objektit dhe parcelave të tokës zonën kadastrale në Fushë Kosovë dhe kjo dëshmohet nga certifikatat e pronësisë. Konsumatori ka theksuar se objektin e ka dhënë me qera Mustafë Abazi NTP "EKO-PELET", por që objekti fatkeqësisht është djegur me datë 06.04.2019. Objekti ka qenë e kyçur në rrjetin energjetik dhe në kohën e lëshimit me qira, qiramarrësi është paraqitur në KEDS - KESCO dhe ka nënshkruar kontratë me KEDS – KESCO dhe se faturat kanë shkuar në emër të qiramarrësit me shifër DPR-90088446. Konsumatori në ankesën e tij ka theksuar se pas djegies së objektit është shkëputur kontrata e qirasë, mirëpo i njëjti i ka mbetur borxh pa paguar për energjinë elektrike në vlerë prej 10,784.99€. Konsumatori gjithashtu ka theksuar se objekti është l shkyçur nga rrjeti elektrik dhe se edhe përkundër kërkesës së pronarit G.T. për kyçje në rrjetin elektrik, KEDS i ka theksuar se pa u paguar borxhi i mbetur në atë shifër nuk do të bëhet kyçja në rrjetin elektrik.

Provë: Ankesa e konsumatorit në ZRRE-së

Bordi i ZRRE pas analizave të të gjitha dëshmive të paraqitura nga konsumatori dhe KESCO/KEDS, ka vërejtur se:

Sipas transaksioneve të konsumatorit të shifrës DPR – 90088446 vërehet se kjo shifër për herë të parë është regjistruar me datë 09.10.2013, fatura a parë i ka shkuar për periudhën 09/2013, ndërsa kontrata për furnizim me energji elektrike mes e KESCO për shifrën DPR – 90088446 është bërë me konsumatorin NTP "EKO-Pelet" Avni Abazi dhe kjo kontratë është nënshkruar me datë 30.04.2014. Bazuar në transaksionet e konsumatorit të shifrës DPR – 90088446 e të regjistruar në emër të NTP "EKO-Pelet" Avni Abazi deri më datën 19.06.2019 borxhi i përgjithshëm i energjisë elektrike është 10784.99€, i cili borxh ka mbetur i papaguar.

Provë: Kontrata e furnizimit me energji elektrike e datës 30.04.2014 dhe transaksionet e konsumatorit të shifrës DPR – 90088446

Parashtruesi i ankesës ka sjellur edhe kontratën për qeranë të datës 01.04.2013 e lidhur me G.T. si qeradhënësi dhe NTSHP "Oferta" të përfaqësuar nga Avni Abazi si qeramarrës. Duhet theksuar se në kontratën e qerasë në pikën 8 theksohet se kontestet eventuale nëse nuk mund të zgjidhen mes palëve, do të barten në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

Provë: Kontrata e qerasë mes G.T. dhe NTSHP "Oferta" të përfaqësuar nga Avni Abazi

Pas analizimit të rastit, ZRRE i është drejtuar KESCO se a kanë filluar veprimet ligjore ndaj konsumatorit Avni Abazi" NTP EKO-PELET" për inkasimin e borxhin të energjisë elektrike të pa paguar. KESCO është përgjigjur ZRRE-së duke theksuar se për konsumatorin NTP "EKO-PELET" me shifër DPR 90088446 KEDS me date 23.11.2018 ka iniciuar lëndën në përmbarim te përmbaruesi për vlerën e borxhit të energjisë elektrike në vlerë prej 10,765.53€ dhe atë për periudhën kohore 02.10.2015 - 16.10.2018. KEDS a theksuar se nga përmbaruesi është marr informata se është tentuar të ekspedohet lënda me postë me datë 30.11.2018 mirëpo nga posta është kthyer përgjigje se ky biznes është i shuar. KESCO në përgjigje ka theksuar se prapë më vonë është provuar të bëhet ekspedimi i lëndës në terren nga përmbaruesi së bashku me përfaqësuesin e KEDS, mirëpo përsëri nuk ka qenë e mundur për shkak se objekti është i mbyllur. KESDO në përgjigjen e tyre kanë theksuar



se sipas përmbauesit meqenëse lënda nuk ka mundur të ekspedohet në terren nuk kanë mundur edhe të merren veprimet e tjera përmbaimore. KESCO gjithashtu në përgjigjen e tyre kanë theksuar se lidhur me kërkesën e aplikuesit për kyçje të re G.T. në lokacionin e shifrës ekzistuese, qëndrimi i KEDS dhe KESCO është që përderisa ka borxh në shifrën ekzistuese, dhe asnjëherë nuk është pranuar kërkesa nga qiradhënësi as qiramarrësi se janë ndërprerë marrëdhëniet kontraktuale mes palëve e për çfarë KEDS apo KESCO nuk kanë për obligim verifikimin e tillë, borxhi duhet të paguhet në tërësi, e pastaj të energjizohet lokali, sepse subjekt i procedurës përmbaimore është njëhori i cili e ka furnizuar me energji elektrike këtë lokal. Gjithashtu KESCO në përgjigjen e tyre ka theksuar se përderisa palët kanë pasur raporte kontraktuale respektivisht qiraxhiu ka paguar qiranë, ka qenë përgjegjësi e qiradhënësit që më herët të kërkoj gjendjen e energjisë elektrike, pasi në lokalin e njëjtë ka pasur pajisje që është dashur kohë për ti lëvizur. Andaj palët në fjalë respektivisht qiraxhiu me qiramarrësin duhet të lidhin kontratë me përmbauesin për pagesën e borxhit të dërguar në përmbaimit dhe më pas KEDS do të rikyç energjinë elektrike në shifrën e njëjtë ekzistuese dhe do të bëjë rregullimin kontraktual ashtu siç palët gjejnë pajtim.

Provë: Korrespondenca mes ZRRE dhe KESCO si dhe Propozimi për përmbaimit

Sipas nenit 51, paragrafi 4 të Ligjit Nr. 05/L - 085 për Energjinë Elektrike theksohet se: *“Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes mund ta refuzojë përkohësisht kyçjen e një konsumatori ose prodhuesi në sistem, nëse konstaton se pajisjet e konsumatorit apo të prodhuesit nuk plotësojnë normat teknike ose kushtet tjera të përshkruara në Kodin e rrjetit të transmetimit dhe Kodin e rrjetit të shpërndarjes. Konsumatori ose prodhuesi duhet të informohet me shkrim për arsyet e çdo refuzimi të tillë”*. Gjithashtu sipas nenit 10, paragrafi 1 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji theksohet se: *“Operatori i Sistemit mund të refuzojë të kyçë një aplikues përkohësisht, vetëm nëse ajo kyçje nuk është në përputhje me dispozitat e Kodit të Rrjetit dhe Shpërndarjes ose kodeve tjera në fuqi”*. Pra bazuar në këto dispozita ligjore të lartcekura dhe në përgjigjen e KESCO/KEDS dhënë konsumatorit, ZRRE ka vërejtur se KESCO/KEDS ka refuzuar kyçjen e konsumatorit jo për shkak të kushteve teknike të konsumatorit por për shkak se në atë parcel të tokës ka ekzistuar një objekt, i cili objekt është djegur, por i cili ka pasur shifër të regjistruar në KESCO dhe ende posedon një borxh të energjisë elektrike të papaguar.

Sipas nenit 5, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji theksohet se të gjithë konsumatorët janë të obliguar të paguajnë për energjinë e shfrytëzuar, sipas kontratës për Furnizim me Energji të lidhur me Furnizuesin e Energjisë, si dhe për tarifën për shfrytëzim të sistemit të miratuara nga ZRRE-ja. Por që në rastin në fjalë duhet theksuar se kontrata për furnizim me energji elektrike ka qenë e nënshkruar mes KEDS dhe NTP “Eko-Pelet” e me përfaqësim të Avni Abazi, por që nuk janë paguar të gjitha faturat e energjisë elektrike nga konsumatori i kësaj shifre dhe rrjedhimisht është krijuar borxhi i energjisë elektrike prej 10,765.53€. Gjithashtu duhet theksuar se sipas dëshmimeve të paraqitura vërehet se me datë 23.11.2018 për borxhin e krijuar prej 10,765.53€ nga konsumatori NTP “Eko-Pelet” e me përfaqësim të Avni Abazi, KEDS ka iniciuar lëndën te përmbauesi për përmbaimit, mirëpo për shkak se biznesi është i shuar dhe pasi që nuk është gjetur konsumatori në fjalë, lënda ka mbetur e pazbatuar.

Lidhur me konstatimin e KESCO që është dhenë në përgjigjen e tyre për parashtruesin e kërkesës se sipas pikës 8 të kontratës së qerasë mes G.T. dhe NTP “Eko-Pelet” Avni Abazi, theksohet se kontestet eventuale nëse nuk mund të zgjidhen mes palëve, do të barten në Gjykatën Themelore në Prishtinë, kjo është shumë e saktë dhe se kjo ka të bëjë me mosmarrëveshjet mes të dy palëve, por jo për shpenzimet tjera si ajo e energjisë elektrike. Duhet theksuar se përgjegjëse për inkasimin e borxhit të energjisë elektrike është Furnizuesi i energjisë elektrike – KESCO dhe se procedurat e inkasimit janë të rregulluara, madje edhe veprimet e KESCO/KEDS për të dërguar lëndën te përmbauesi janë procedura ligjore për inkasim.



Bordi i ZRRE bazuar në të gjitha shkresat e lëndës ka vërejtur se me datë 01.04.2013 është nënshkruar kontrata e qerasë lidhur mes G.T. si qeradhënës dhe NTSHP “Oferta” të përfaqësuar nga Avni Abazi (më vonë NTP “Eko-Pelet” Avni Abazi) si qeramarrës, dhe se pas kësaj qeramarrësi me datë 30.04.2014 ka nënshkruar kontratën për furnizim me energji elektrike me KESCO në shifrën DPR – 90088446. Gjithashtu ZRRE ka vërejtur se në shifrën DPR – 90088446 ka mbetur një borxh i energjisë elektrike i papaguar dhe për këtë KEDS/KESCO ka dërguar lëndën për përmbarim te përmbaruesi për konsumatorin NTP “Eko-Pelet” Avni Abazi për borxhin e energjisë elektrike në vlerë prej 10,765.53€ ndaj KESCO dhe atë për periudhën kohore 02.10.2015 - 16.10.2018. Pra ZRRE konstaton se KESCO/KEDS ka ndërmarrë veprime ligjore për të arritur të inkasojë borxhin përmes përmbaruesit dhe se edhe përkundër asaj që sipas të dhënave të KESCO/KEDS përmbarimi nuk ka mundur të ndodhë për arsye përmbaruesi nuk ka arritur ta gjejë konsumatorin pas biznesi i tij është shuar dhe se nuk gjendet konsumatori pasi objekti është djegur. Lidhur me këtë ZRRE konstaton se parashtruesi i kërkesës G.T. nuk e ka shkaktuar borxhin e energjisë elektrike të shifrës DPR – 90088446, objekti është djegur, si dhe duke pasur parasysh se KESCO/KEDS ka ndërmarrë veprime ligjore për të arritur të inkasojë borxhin përmes përmbaruesit, atëherë duhet t’i ipet parashtruesit të kërkesës G.T. lidhja e re dhe kyçja në rrjetin elektrik.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 27.12.2019 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Konsumatorit: G.T.
- KESCO-së dhe
- Arkivit të ZRRE-së.